ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë**
Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **204-25-4849-2-1-1**
Sa i përket tenderit për: **Krijimi dhe mirëmbajtja e regjistrit të pronarëve përfitues**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Cacttus Sh.a.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Bashkim Fehmiu 3 BC2/11 V1-Lo1-S

(Adresa)

Prishtinë — *(Vendi)*

10000 — *(Kodi postar)*

+383(0) 38 600 488 — *(Numri Telefonit)*

N/A — *(Numri i Faks-it)*

z. Armend Malazogu-Drejtor Menaxhues

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@cacttus.com

(Adresa elektronike)

14.07.2025

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

CACTTUS SHPK PRISHTINË KOSOVË 1

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Njoftimi për Kontratë – 02.06.2025
- Kërkesa për informacione shtesë – 01.07.2025
- Përgjigja nga AK në Kërkesën për informacione shtesë – 02.07.2025
- Kërkesa për Rishqyrtim- 08.07.2025
- Vendimi mbir rishqyrtimin e aktivitetit te prokurimit- 10.07.2025
- Ankesa OSHP- 14.07.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☐

Ankesa eshte ne fazën para hapjes se tenderit

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** ☐

Vendimi i autoritetit kontraktues ne raport me kërkesën për rishqyrtim është refuzuar. Te bashkangjitur ne kete ankesë gjeni vendimin e ndërmarr nga Autoriteti Kontraktues.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP– Qëllimi Neni 7 i LPP - Barazia në Trajtim/Jo- Diskriminimi Neni 69 i LPP - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale Neni 25 i RrPP - Kriteret e përzgjedhjes

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Kronologjia e fakteve dhe Analiza e Ankesës Duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), parashtrojmë Ankesë ndaj vendimit të autoritetit kontraktues te datës 10.07.2025.

ANKESË

Duke marrë parasysh kerkesat dhe kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, ne si Operator Ekonomik kemi ushtruar të drejtën tonë ligjore për të paraqitur një kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues (AK). Në rastin konkret, më datë 10.07.2025, kemi pranuar vendimin e AK-së, me të cilin është refuzuar kërkesa jonë për rishqyrtim në të gjitha pikat e kontestuara.

Megjithatë, vërejmë se në arsyetimin e këtij vendimi AK nuk ka ofruar asnjë analizë objektive apo përgjigje për pretendimet tona lidhur me natyrën diskriminuese dhe kufizuese të kërkesave të vendosura në FDT. Përkundrazi, vendimi përmban thjesht një ripërsëritje të kritereve fillestare, pa ndonjë ndryshim ose sqarim shtesë, gjë që tregon për mospërfillje të plotë të pretendimeve tona të argumentuara dhe të bazuara në ligj.

Për rrjedhojë, ne si OE kemi vendosur që përmes kësaj ankese të paraqesim sërish para jush, të nderuar anëtarë të Panelit Shqyrtues të OSHP-së, faktet dhe dëshmitë që tregojnë qartë se kërkesat në fjalë janë të paprecedenta dhe në kundërshtim me frymën e Ligjit për Prokurimin Publik dhe akteve përkatëse nënligjore.

Në vijim, paraqesim në mënyrë të detajuar pretendimet tona ankimore, me referenca të qarta ndaj dispozitave ligjore përkatëse dhe praktikave të pranuara të prokurimit.

Në këtë rast konkret, ankesa jonë drejtohet kundër përmbajtjes së dosjes së tenderit, konkretisht kritereve të vendosura në pikat 9.1 dhe 9.2 të FDT-së – "Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale."

Në këtë aktivitet prokurimi, është kërkuar që OE të angazhojë staf për pozitat:

- Menaxher i Projektit,
- Arkitekt i Sistemeve Softuerike dhe Bazës së të Dhënave,
- Zhvillues Senior i Sistemeve Softuerike,
- Zhvillues i Web Shërbimeve dhe Web API-ve,
- Trajner i sistemit.

Kriteret e vendosura për këto pozita janë tepër rigoroze dhe joproporcionale, duke kufizuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë dhe duke cenuar në mënyrë të drejtpërdrejtë parimin e trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe konkurrencës së ndershme, të garantuara me nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Një qasje e tillë krijon në praktikë një avantazh të pajustifikuar për operatorë të caktuar, duke përjashtuar padrejtësisht të tjerët që zotërojnë kapacitete profesionale të krahasueshme dhe të mjaftueshme për përmbushjen e kontratës.

Kjo situatë bëhet edhe më serioze në kontekstin e numrit të madh të pozitave të kërkuara, i cili e shton ndikimin përjashtues të kritereve kufizuese dhe e bën këtë praktikë të papranueshme në një procedurë publike që duhet të karakterizohet nga konkurrencë reale dhe e barabartë.

Me poshtë janë renditur pretendimet ankimore.

Pretendimi ankimor 1.

Kërkesa në FDT për kualifikimin universitar të stafit.

AK ka kërkuar që të ofrohen: Diplomë Bachelor apo Master (varësisht pozitës) në Inxhinieri Kompjuterike ose Shkenca Kompjuterike ose Inxhinier i Diplomuar i Kompjuterikes me Telekomunikacion ose drejtime të ngjashme kompjuterike ose TIK.
Formulimi aktual kërkon diploma vetëm nga disa drejtime lidhur me drejtime kompjuterike ose TIK, duke përjashtuar fusha të tjera, që varësisht akreditimeve te ndryshme te universiteteve, kane emërtime të ndryshme, e që jane drejtime kompetente,
të kualifikuara dhe valide për përmbushjen e kërkesave dhe detyrave të këtyre pozitave të kërkuara si Inxhinieri Elektronike, Sisteme Informative, Inxhinieri Telekomunikacioni dhe Rrjetesh Inxhinieri Softuerike (Software Engineering), Sisteme Informative (Information Systems), Inxhinieri e Telekomunikacionit, Inxhinieri Elektronike, Inxhinieri Elektroteknike, Inxhinieri Elektrike me specializim në sisteme kompjuterike apo automatizim, Teknologji Informative dhe Komunikim (TIK/ICT), Shkenca të Aplikuara Kompjuterike, Inxhinieri e Rrjeteve dhe Komunikimit, Shkenca të të Dhënave dhe Inteligjencë Artificiale (Data Science and AI), Inxhinieri Industriale me orientim në sisteme informatike, Matematikë/Informatikë me fokus në programim apo sistemet kompjuterike, Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit, Shkenca Kompjuterike me Telekomunikacion, etj.
Po ashtu, disa nga drejtimet e kërkuara nga ju janë emërtime të akreditimeve të vjetra të universiteteve të ndryshme, të cilat tanimë nuk ekzistojnë dhe janë ristrukturuar në emërtime tjera.
Prandaj, kërkojmë nga ju që të mundësoni që këto kërkesa të ndryshohen në:
Të ketë diplomë universitare (Bachelor ose Master) në një fushë relevante të teknologjisë së informacionit si: Inxhinieri Kompjuterike, Shkenca Kompjuterike, Inxhinier i Diplomuar i Kompjuterikes me Telekomunikacion, Inxhinieri Elektronike, Sisteme Informative, Inxhinieri Telekomunikacioni dhe Rrjetesh Inxhinieri Softuerike (Softëare Engineering), Sisteme Informative (Information Systems), Inxhinieri e Telekomunikacionit, Inxhinieri Elektronike, Inxhinieri Elektroteknike, Inxhinieri Elektrike me specializim në sisteme kompjuterike apo automatizim, Teknologji Informative dhe Komunikim (TIK/ICT), Shkenca të Aplikuara Kompjuterike, Inxhinieri e Rrjeteve dhe Komunikimit, Shkenca të të Dhënave dhe Inteligjencë Artificiale (Data Science and AI), Inxhinieri Industriale me orientim në sisteme informatike, Matematikë/Informatikë me fokus në programim apo sistemet kompjuterike, Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit, Shkenca Kompjuterike me Telekomunikacion, etj.

Pretendimi ankimor 2.

Kërkesa në FDT që Menaxheri i projektit të ketë: Certifikime menaxheriale: I certifikuar ne PMP (Project Management Professional) nga Project Management Institute.
Kriteri i përcaktuar në dosjen e tenderit për pozitën e menaxherit të projektit, ku kërkohet ekskluzivisht: *"I certifikuar në PMP (Project Management Professional) nga Project Management Institute"*, është tejet kufizues dhe në kundërshtim me parimet themelore të Ligjit për Prokurimin Publik, përkatësisht me nenin 7 që garanton trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin dhe konkurrencën e drejtë.
Ky formulim nuk ofron mundësinë e pranimit të certifikimeve të tjera relevante dhe të njohura ndërkombëtarisht në fushën e menaxhimit të projekteve, si p.sh. PRINCE2, IPMA, PMI-ACP, etj., të cilat janë të krahasueshme në përmbajtje dhe standarde me PMP-në dhe janë gjerësisht të pranuara në tregun ndërkombëtar të punës.

Si i tillë, ky kriter ka efekt përjashtues dhe i mohon pjesëmarrjen operatorëve ekonomikë që posedojnë certifikime profesionale të vlefshme, por jo specifikisht PMP, duke përbërë kufizim të pajustifikuar të konkurrencës.

Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues ta rishqyrtojë këtë kriter dhe ta zgjerojë formulimin e tij në mënyrë që të përfshijë edhe certifikimet tjera ndërkombëtare të pranuara në fushën e menaxhimit të projekteve, në përputhje me frymën e LPP-së dhe praktikave të hapura dhe jo-diskriminuese të prokurimit.

Pretendimi ankimor 3.

Kërkesa në FDT lidhur me përvojën e Menaxherit të projektit dhe Arkitektit të Sistemeve Softuerike: 10 vjet përvojë profesionale pas diplomimit master në në menaxhimin e projekteve të zhvillimit të softuerit, mundësisht aplikacionet ASP.NET/në projekte të zhvillimit të softuerit, mundësisht aplikacionet ASP.NET.

Kërkesa që përvoja profesionale të llogaritet vetëm pas diplomës së nivelit master është kriter i paqartë, i pajustifikuar dhe në kundërshtim me parimet themelore të Ligjit për Prokurimin Publik, përkatësisht nenit 7 dhe nenit 52.
Ky formulim përjashton automatikisht kandidatët që posedojnë diplomë bachelor dhe përvojë të konsiderueshme e të barasvlershme në fushë, madje edhe në rastet kur janë të certifikuar me certifikime ndërkombëtare si PMP për Menaxherin e Projektit e Microsoft .NET për Arkitektin e Sistemeve Softuerike.
Kjo përbën një kriter kufizues dhe diskriminues, që nuk bazohet në ndonjë arsye objektive ose funksionale për pozicionin e kërkuar, dhe rrjedhimisht redukton në mënyrë artificiale pjesëmarrjen dhe konkurrencën në këtë procedurë.
Kërkojmë që ky kriter të rishqyrtohet dhe të përmirësohet, duke i dhënë mundësi të barabartë të gjithë kandidatëve me diplomë të nivelit bachelor dhe përvojë të dëshmuar, në përputhje me nenin 7 të LPP-së, si dhe me nenin 25 të RrPP.

Pretendimi ankimor 4.
Kërkesa në FDT për vitet e përvojës: 10 vite për Menaxherin e Projektit e Arkitektin e Sistemeve Softuerike, 5 vite për Zhvilluesin Senior të Sistemeve Softuerike.

Këto kërkesa janë joproporcionale dhe të pajustifikuara në raport me natyrën e kontratës dhe zhvillimet aktuale në industrinë e teknologjisë së informacionit.
Këto kufizime të tepruara ngushtojnë ndjeshëm konkurrencën, pasi përjashtojnë një numër të konsiderueshëm profesionistësh të kualifikuar, të cilët edhe pse mund të kenë përvojë të madhe praktike dhe certifikime ndërkombëtare, nuk arrijnë kufirin e viteve të përvojës të kërkuar – shpesh për arsye të lidhura me rrugët akademike ose përvojën e fituar para diplomimit.
Kërkesa për një përvojë të tejzgjatur nuk garanton domosdoshmërisht performancë më të lartë, sidomos në një sektor që ndryshon dhe përparon me ritme të larta, ku shpesh njohuritë më të reja dhe përvojat në projekte të fundit janë më të vlefshme se vetë vjetërsia në punë.
Kërkojmë që këto kritere të rishikohen dhe të harmonizohen me praktikën aktuale të industrisë dhe frymën e Ligjit për Prokurimin Publik, duke mundësuar që:

- Për Menaxherin e Projektit dhe Arkitektin e Sistemeve Softuerike, të kërkohen 4 vite përvojë relevante,
- Për Zhvilluesin Senior, të kërkohen 3 vite përvojë relevante.

Ky rishikim do të mundësonte rritjen e konkurrencës së ndershme dhe pjesëmarrjen e profesionistëve të kualifikuar, në përputhje me nenin 7 të LPP-së dhe standardet evropiane të prokurimit.
Si provë shtesë lidhur me këtë pikë, po bashkangjesim me ankesën tonë edhe vendimin e OSHP nr. 2024/1070 lidhur me një aktivitet prokurimi të natyrës dhe vlerës së ngjashme.

Bazuar në faktet dhe argumentet e paraqitura, kërkojmë nga OSHP te nxjerr:

VENDIM

1. **Të pranojë ankesën tonë si të bazuar;**
2. **Të urdhërojë rishikimin dhe ndryshimin e kritereve të përcaktuara në FDT nga AK,** në përputhje me nenin 7 dhe 52 të LPP-së, si dhe standardet e barazisë, mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit;
3. **Të sigurojë që procesi i prokurimit të jetë i hapur, konkurrues dhe i drejtë**, duke mundësuar pjesëmarrjen e operatorëve të kualifikuar, pa kufizime të panevojshme apo të pajustifikuara.

Jemi të gatshëm të bashkëpunojmë dhe të dorëzojmë çdo dokumentacion shtesë që OSHP mund të kërkojë gjatë shqyrtimit të kësaj ankese.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Përveç shkeljeve të konstatuara më parë, ne gjithashtu jemi të dëmtuar nga shpenzimet e bëra me rastin e përgatitjes së kërkesës për rishqyrtim. si dhe ankese. Këto shpenzime përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- **Shpenzimet për përgatitjen e Kërkesës për Rishqyrtim dhe ankeses**: Këto përfshijnë kostot për hartimin e kërkesës, mbështetjen ligjore dhe administratën e nevojshme për paraqitjen e ankesës, si dhe përgatitjen e dokumentacionit dhe provave përkatëse.

Për këto arsye, kërkojmë që në përfundim të shqyrtimit të ankesës sonë, të merret parasysh dhe kompensimi i shpenzimeve të bëra, si dhe humbja e fitimeve të pritura si pasojë e shkeljeve të bëra nga Autoriteti Kontraktues.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe

g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*